

RAPORT VJETOR 2017



Të ofrojmë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, veçanërisht për popullsinë që jeton në zonat rurale të Shqipërisë, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe reduktimin e përgjithshëm të varfërisë. Ne operojmë në mënyrë miqësore, duke përdorur praktikat e bankingut modern.

- Shërbime financiare në zonat rurale
 - Mbështetje ndaj sipërmarrjes rurale dhe nxitje për aktivitetet prodhuese
 - Rritje e punësimit
 - Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit bujqësor
-
- Institucion financiar në pronësi të anëtarësisë dhe pa qëllim fitimi
 - Produkte konkurruese dhe të përshtatura, që respektojnë mjedisin
 - Standarde të larta etike dhe profesionale



1. Mesazh nga Drejtorja Ekzekutive	5
2. Qeverisja e SHKK FED invest	7
3. Treguesit Operacionalë	8
4. Treguesit Financiarë	9
5. Investime në Infrastrukturë	10
6. Zhvillime Kryesore në Vitin 2017	11
7. Zhvillime Organizative dhe Strukturore	12
8. Partnerët dhe Projektet	14
9. TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit	18
10. Pasqyrat Financiare	20
11. Raporti i Auditit të Jashtëm	22
12. Objektivat për vitin 2018	25



Në foto: SHKK PETRELË, Dhënie Kredie (1996)



Në foto: 15 vjet kredi rurale (2007)

Formalizimi

1992 - 1998

Iniciativë e Bankës Botërore
Filluar me 20 mijë \$
Zbutja e varfërisë

Zhvillimi

1999 - 2002

Ligj i posaçëm
Krijimi i SHKK-ve
Mbështetje nga Banka Botërore
Asistencë teknike nga Banka e Shqipërisë

Zgjerimi

2003 - 2014

Rritja e portofolit të kredisë dhe depozitës
Top 20 IMF (MIX)
Qëndrueshmëri financiare
Gjithëpërfshirje në qeverisjen korporative

Konsolidimi

2015 - 2016

Procesi i konsolidimit
Ligj i ri për SHKK-të
Ndryshimi i legjislacionit për ASD.
Bazë rregullatore e re.
Agro-rritje
Partneritete të reja: KFW, EFSE DF, RIAS, JICA

Vizioni

2017

Më shumë kredi
Më shumë depozita
Zgjerimi i shërbimeve
Agro dhe SME
Futja e teknologjive të reja
Përgjegjësi sociale
Mbrojtja e mjedisit



Të nderuar lexues, anëtarë,
të zgjedhur dhe kolegë të SHKK FED invest,

Kam kënaqësinë të ndaj me ju raportin vjetor të veprimtarisë së FED invest për vitin 2017, vit i cili kurorëzoi 25 vjet aktivitet të suksesshëm në fushën e financave sociale dhe konfirmoi vazhdimësinë e qëndrueshmërinë institucionale. Të paktë qenë ata që besuan, se ajo që filloi si një projekt modest në vitet '90, do të merrte përmasa kaq të gjera, duke i qëndruar besnik targetit të synuar të popullsisë.

FED invest është një eksperiencë unike, jo vetëm profesionale, por edhe njerëzore e shprehur në rritjen e vazhdueshme të anëtarësisë dhe besnikërisë së klientëve. Me angazhimin, përkushtimin dhe transparencën në shërbimet që ofrojmë, kemi marrë besimin dhe vlerësimin e më shumë se 51.000 anëtarëve në rrjetin tonë.

Pas realizimit me sukses të konsolidimit të 70 Shoqërive të Kursim Kreditit dhe licencimin në mars 2016 të FED invest, shifrat e aktivitetit për këtë periudhë 2 vjeçare, konfirmojnë drejtësinë e vendimit të marrë dhe janë tejet optimiste: portofoli i kredive të FED invest është rritur me 25.5%, portofoli i depozitave me 43 % dhe numri i anëtarëve me 48 %.

Viti 2017 shënoi fillimin e fazës së parë të zbatimit të biznes planit strategjik 3-vjeçar, të hartuar me mbështetjen e partnerëve tanë strategjikë. Ne u anagazhuam seriozisht në konsolidimin e sistemit të qeverisjes korporative, hartimin e strategjisë afatmesme, përsosjen e menaxhimit operacional dhe financiar, përmirësimin e nivelit të shërbimit ndaj anëtarësisë, rritjenetransparencës dhe efikasitetit operacional. Ky vit gjithashtu, shënon arritje në ngritjen e kapaciteteve në fushën e agrofinancës dhe SME-ve, përmirësimin e shërbimit në degë, rritjen profesionale të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe rekrutimeve të reja cilësore.

Nëpërmjet instrumentesh financiarë të përshtatur ndaj nevojave lokale dhe një filozofie institucionale unike, FED invest është në shërbim të popullsisë rurale, përgjithësisht të anashkaluar dhe aktualisht shërbimi ynë ofrohet në 1,500 fshatra.

FED invest, i ndërgjegjshëm për sfidat e mëdha në krijimin e konsolidimit e Institucionit, është investuar seriozisht në identifikimin dhe realizimin e bashkëpunimeve të frytshme me partnerë të rëndësishëm strategjikë.

Falë bashkëpunimit të shkëlqyer me JICA-n, parashikojmë futjen e një Sistemi të ri Operativ që do të ofrojë gjithë funksionalitetet e shërbimeve bankare dhe do të na hapë rrugën për shërbime në distancë, me kosto të përballueshme për anëtarësinë.

Ndërsa vazhdojmë punën mbi themelet që kemi vendosur, me besimin e plotë se edhe 2018 do jetë një sukses në rrugën e realizimit të objektivave strategjike, unë do të doja të falenderoja anëtarësinë tonë për mundësinë që na dha t'u shërbejmë nevojave të tyre, Këshillin Drejtues për vizionin largpamës, dialogun e hapur e konsultat e vazhdueshme, si dhe stafin e FED invest për përkushtimin e vazhdueshëm dhe profesionalizmin.

Lexim të këndshëm!

Zana Konini
Drejtoresh Ekzekutive

IMPAKTI EKONOMIK



IMPAKTI SOCIAL

Përgjatë viteve:

- ▶ Mbi 150,000 kredi.
- ▶ Mbi 52 miliardë Lekë kredi të disbursuara.
- ▶ Viti 1992: Shuma mesatare e kredisë 10 000 Lekë.
- ▶ Viti 2017: Shuma mesatare e kredisë 350 000 Lekë.
- ▶ Aktualisht, mbi 220 të punësuar.

Për çdo kredi të re:

- ▶ 1.4 vende pune të reja.
- ▶ Impakt në shumë biznese të reja.

Grupi i synuar:

- ▶ Fermerët, sipërmarrësit e vegjël dhe familjet rurale dhe urbane, të pashërbyera financiarisht.

- ▶ Ndhimë financiare për ata individëve që nuk përfitojnë nga shërbimet bankare.
- ▶ Module trajnimi për zhvillimin e biznesit në aspektin e njohurive profesionale.
- ▶ Ndikim në uljen e emigracionit dhe papunësisë.
- ▶ Zhvillimi i lidershipit lokal.
- ▶ Rritja e ndjeshmërisë së komuniteteve lokale, ndaj shërbimeve tona financiare.
- ▶ Mbulimi me shërbimet tona financiare e mbi 80% të territorit të vendit.
- ▶ Prioriteti ynë janë zonat e largëta dhe rurale.



Përgjegjësia Sociale

FED invest është investuar gjatë viteve 2016-2017 për sigurimin dhe mbrojtjen e serave të prodhimit bujqësor nga fatkeqësitë natyrore me pasoja ekonomike për fermerët. Nga projekti i sigurimit të serave për vitin 2017, janë dëshmepërblyer 30 anëtarë dhe shuma totale kap vlerën 3 milionë lekë.


Këshilli Drejtues

- 1) Z. Mehdi Pepa - Kryetar
- 2) Z. Valentin Gocaj - Nënkryetar
- 3) Znj. Zana Konini – Anëtare
- 4) Z. Namik Zeneli – Anëtar
- 5) Z. Xhevdet Kapaj – Anëtar
- 6) Z. Hasan Shehu – Anëtar
- 7) Z. Zyjdi Boja - Anëtar



Komiteti i Kontrollit

- 1) Znj. Haxhire Demirxhiu;
- 2) Znj. Lefteri Liçka;
- 3) Z. Flamur Roshi






JANAR 2016 – DHJETOR 2017


+25% Rritje

Portofoli i kredisë, në milionë lekë




+43% Rritje

Portofoli i depozitave, në milionë lekë



+48% Rritje

Anëtarësia



57% Rritje

Aktivitet në milionë lekë



PORTOFOLI I DEPOZITAVE

Portofoli i depozitave në 31 Dhjetor 2017 rezultoi 3,46 miliardë lekë, me një rritje prej 27.7% në krahasim me vitin 2016. Ky portofol shënon rritje për të tetin tremujor rradhazi, duke arritur 43% gjatë dy viteve të fundit.


PORTOFOLI I KREDISË

Portofoli i kredisë në 31 Dhjetor 2017 arriti shumën 3,44 miliardë lekë, me një rritje prej 14.4% në krahasim me vitin 2016, dhe rritje 25.5% gjatë dy viteve të fundit. Rritja konsiston si në rritjen e volumit të kredisë në tërësi, ashtu dhe në rritjen e numrit të kredive të disbursuara. Gjatë 2017 janë disbursuar në total 3.7% më shumë kredi se një vit më parë, të investuara më së shumti në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë.


CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË

Gjatë vitit 2017, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Rabobank, FED invest u angazhua për përmirësimin e strukturave dhe akteve rregullatore sa i përket gjurmimit, monitorimit dhe adresimit të niveleve të rrezikut. Në fund të vitit 2017 portofoli në risk mbi 90 ditë nuk e kaloi nivelin prej 4.5%.


Sipas sektorëve të aktivitetit




Risku sipas sektorëve të aktivitetit



Sipas maturimit fillestar




Sipas shumës së disbursuar





Krijimi i markës FED invest është shoqëruar njëkohësisht me një plan ambicioz të Institucionit për krijimin e një infrastrukture optimale, me parametra të lartë cilësorë, për zhvillimin e aktivitetit të biznesit dhe përmirësimin e kushteve të punës. Si pjesë e strategjisë së Institucionit, në fund të vitit 2017 mbi 50% e degëve të rrjetit të FED invest janë tërësisht të rinovuara. Ne synojmë që deri në fund të vitit 2019 të përfundojmë rinovimi i të gjitha degëve të FED invest.



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Anëtare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

Që prej 1 Janarit 2017 pas plotësimit të kriteveve ligjore, FED invest është pjesëmarrës dhe kontribues në skemën e sigurimit të depozitave të anëtarësisë pranë ASD-së. Garantimi i depozitave deri në vlerën 2 milionë lekë ofron më shumë siguri për anëtarët, më shumë depozita dhe rritje e qëndrueshmërisë financiare.

Qëndrueshmëri financiare dhe progres

- Shtirje gjeografike në 1,500 fshatra.
- Prezent në zonën urbane dhe gjysëm urbane.
- Mbulojmë 10 qarqe dhe 30 bashkitë më të mëdha.
- Mbi 51,000 anëtarë.
- Konsolidimi i imazhit.
- Hapja e 5 degëve të reja.

Qeverisja korporative

Në 29 Prill 2017 u organizuan votimet në Njësitë Bazë dhe Grup Njësi për përzgjedhjen e delegatëve në Asambleenë e Përgjithshme, si organi më i lartë vendimmarrës i Institucionit tonë.



Burimet Njerëzore

Në perfundim të vitit 2017, FED invest numëron 228 punonjës me një rritje prej 8.5% krahasuar me një vit më parë. Në mënyrë konstante Departamenti i Burimeve Njerëzore i ka kushtuar rëndësi metodologjisë dhe përmirësimit të skemave motivuese e vlerësuese për punonjesit. Në të njëjtën kohë, kujdes i veçantë i është kushtuar edhe përzgjedhjes së tematikave të trajnimit për stafin, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore në një stad të ri më të lartë. Kjo praktikë pune sigurisht synon edhe përmirësimin e shërbimit në tërësi ndaj anëtarësisë.

Njësia Agro-SME

Në funksion të adresimit të specializuar të sfidave me të cilat përballet sektori bujqësor dhe sipërmarrjet e vogla dhe të mesme që operojnë në këtë sektor në vitin 2017, si pjesë e planit afatmesëm të biznesit të FED invest, u ngrit Sektori Agro & SME. Ndër të tjera, ky sektor do të mbulojë dhe ofrojë konsulencë profesionale pranë bizneseve të vogla dhe të mesme të interesuara për të investuar në bujqësi dhe blegtori. Për arritjen dhe përballimin e sfidave përkatëse të zhvillimit ky sektor do të asistohet në mënyrë të dedikuar për ngritjen e kapaciteteve përkatëse profesionale si nga FED invest, ashtu edhe nga ekspertë të Rabobank dhe JICA-s.

Njësia Operacionale

Gjatë vitit 2017, me objektiv për një riorganizim më efikas dhe efektiv të proceseve operacionale në qendër e në degë dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet bankare është krijuar një njësi e veçantë operacionale. Është bërë një punë e konsiderueshme për përmirësimin e rritjes të degëve të funksioneve operacionale dhe rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve.

MIS - Njësia e Raportimeve

Për një komunikim më eficient në raport me palët e treta dhe autoritetet rregullatore vendase, u krijua një njësi e specializuar për analizat, raportimet dhe manaxhimin e informacionit financiar brenda Departamentit të Financës. Njësia zbaton kërkesat dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë si dhe ASD-së, siguron raportime dhe analiza për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm.

"Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve financiare, me qëllim zhvillimin ekonomik të Shqipërisë rurale"

Ky projekt i FED invest, me asistencën teknike të RIAS dhe EFSE DF, synon përmirësimin strukturor të përfshirjes financiare në Shqipëri, si kontribuese e zhvillimit të ekonomisë dhe rritjen e nivelit të jetesës së popullsisë në zonat rurale. Objektivat afatgjatë të FED invest janë të lidhura me zbatimin cilësor të këtij projekti ambicioz, duke përbushur kështu aspiratat e FED invest që, mbështetur në lidhjen simbiotike të Institucionit me komunitetin rural, të bëhet aktori më i rëndësishëm i agrofinancës në zonat rurale, financues i një numri më të madh sipërmarrjesh të vogla dhe të mesme, si dhe ofrues i shërbimeve për të gjithë ata, të cilët aktualisht nuk kanë akses në shërbimet financiare. Më konkretisht, ky projekt synon **(i)** përmirësimin e modelit qeverisës korporativ, **(ii)** ngritjen e kapaciteteve lokale për zhvillimin e agrobizneseve, **(iii)** zhvillimin e aftësive për biznes të fermerëve, **(iv)** investimet në burimet njerëzore dhe **(v)** zhvillimin e teknologjisë së informacionit.



Përfshirja financiare e fermave familjare në Shqipëri

Në qershor 2017 u nënshkrua marrëveshja midis Qeverive Shqiptare dhe Japoneze dhe në nëntor u lancua projekti **"Mbi përfshirjen financiare të fermave familjare në Shqipëri"**.

Ky bashkëpunim realizohet me mbështetjen e plotë dhe të jashtëzakonshme të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA).

Projekti do të shtrihet në një hark kohor 4 vjeçar dhe synon **(i)** identifikimin dhe adresimin e nevojave për shërbime dhe produkte financiare të popullsisë rurale **(ii)** ngritjen e një qendre për informimin dhe mbështetjen teknike të fermerëve **(iii)** zgjerimin e kapaciteteve teknologjike të FED invest.



Dhjetor 2017 – FED invest bëhet e pjesë e Programit Italo-Shqiptar për zhvillimin e SME-ve. Në kuadër të këtij projekti do të ofrohet mbështetje financiare me norma interesi mjaft të favorshme për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të investojnë në një interval afatgjatë në asete bujqësore.



Nëntor 2017 – Në kuadër të Programit të Komisionit Europian për Punësimin dhe Inovacionin Social që synon zbatimin e strategjisë Europa 2020, FED invest dhe Fondi Europian i Investimeve nënshkruan në Nëntor 2017 marrëveshjen për Instrumentin e Garancisë Financiare. Objekti i marrëveshjes është një fond garancie për mbulimin e rrezikut për volumin e kredive që FED invest parashikon të disbursojë gjatë viteve 2017-2020. Volumi i kredive të reja të parashikuara për t'u shpërndarë nga FED invest tek anëtarësia në këtë hark kohor është €30 milionë.



Linjë garancie me kosto të ulët nga Fondi i Garancisë për Kreditë Rurale (RCGF) Falë bashkëpunimit të shkëlqyer, marrëdhënieve korrekte dhe transparente në zhvillimin e aktivitetit financiar, me RCGF, në muajin korrik 2017, FED invest mundi që të sigurojë një tjetër garanci financiare një vjeçare, me kosto ulët, në vlerën prej €500,000. Kjo garanci i shtohet asaj ekzistuese prej €750,000, duke e çuar vlerën totale të kësaj linje garancie në €1,250,000.



Nëntor - Dhjetor 2017 - Linjë kredie me Fondin Europian për Europën Juglindore (EFSE DF). Pas një proces vlerësimi institucional financiar dhe operacional, FED invest dhe EFSE DF nënshkruan një marrëveshje për disbursimin e €1,500,000, si linjë kredie për FED invest. Përfundimi me sukses i kësaj marrëveshjeje synon që të forcojë edhe më tej imazhin e FED invest, si një institucion i besueshëm në grupin e institucioneve mikrofinanciare.






VLERËSIM PËR KONTRIBUTIN NDËR VITE "GRUAJA SIPERMARRESE"

Ministria e Financës dhe Ekonomisë, nën kujdesin e Kryeministrit të Shqipërisë, për të pestin vit rradhazi organizoi eventin "Bleta e Artë". Qëllimi i këtij eventi është vlerësimi dhe promovimi i sipërmarrësve shqiptarë, dedikimit, punës dhe kontributit të palodhshëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe rritjen e punësimit.

Juria e përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme, vlerësoi Znj. Zana Konini, Drejtore Ekzekutive e FED invest me çmimin "Bleta e Artë" në kategorinë e "Grave Sipermarreë" për kontributin e dhënë në mbështetjen dhe nxitjen e nismave të suksesshme të grave sipërmarrëse në fushën e agrobiznesit në mbarë vendin.



Banka Botërore në raportin e Zhvillimit të Financave Globale për 2017 vlerëson FED invest si histori sukcesi, falë bashkëpunimit të frytshëm me ndërkombëtarët si EFSE DF, JICA dhe Rabobank.



BOX 2.5 Improving Rural Finance in Albania through Knowledge Exchange

In Albania, as in many developing countries, the financing needs of households and firms in rural areas are largely met by cooperative financial institutions (CFIs). Although CFIs have an extensive information network in local areas, their governance and technological and institutional capacity tend to be weak, and their regulation is usually not well defined.

In 2014 the Albanian Savings and Credit Union (ASCU) approached the European Fund for Southeast Europe (EFSE) and Rabobank, an international bank with vast experience in providing financial services to small and unbanked clients, for help in designing and implementing a structural reform that would allow it to professionalize and organize its operations on a par with commercial banks. The ASCU, a CFI that was established in 1992, provides microloans to over 30,000 rural families in Albania (Rabobank 2015). It has built a strong local presence and a healthy asset portfolio, but further growth has been hampered by a weak institutional capacity, a lack of information technology, and limited funding.

The reform was a collaborative effort among regulators, ASCU, and Rabobank, a large Dutch cooperative bank with subsidiaries in 23 develop-

ing countries. They targeted smallholders, small and medium-sized enterprises, and individuals who lacked access to banking services. Their strategy consisted of merging several small savings and credit associations (SCAs) into a one-tier operational structure, with a multitier governance model that would provide the new institution with greater economies of scale in terms of products and services and would improve its access to financial markets, yet with continued bottom-up member involvement.

As part of the reform, the cooperative legal and judicial framework was amended to provide room for the sector to grow and consolidate under a stronger regulatory regime. A more inclusive deposit insurance agency was also designed in order to include financial cooperatives. As a result, by the end of 2015, 70 out of the 84 rural SCAs were merged into one large SCA, even before the new cooperative law was ratified. It was a unique achievement because very few CFIs have leapt forward to welcome a one-tier operational structure. In February 2016, the new financial institution, called FED, was licensed by the Bank of Albania. The EFSE and Rabobank will continue to support FED for three years by providing technical assistance for the restructuring process.



Me mbështetjen e jashtëzakonshme të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), FED invest po zbaton programin kompjuterik të bankingut jashtë dege (Branchless Banking). Ky projekt risi përmirëson edhe më tej efikasitetin e operacioneve të përditshme të Institucionit.



Teknologjia luan një rol të rëndësishëm dhe vendimtar për optimizimin dhe efikasitetin operacional, manaxhimin e rrezikut, raportimet, ndërtimin e strategjive dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientit. Viti 2017 shënoi kalimin online të të gjitha degëve të FED invest, duke përfshirë edhe ato më të largëtat. Pra, tashmë veprimet dhe informimi i anëtarësisë kryhet në kohë reale.

Oficerët e kredisë kanë mundësi të përdorin teknologjinë e kohës me qëllim përshpejtimin e shërbimit ndaj anëtarëve ku të gjitha veprimet kryhen në siguri të plotë përmes mekanizmave të mbrojtjes së informacionit. Gjithashtu, për qëllime raportimi kundrejt organeve mbikëqyrëse apo palëve të treta, është ndërtuar një sistem raportues i standardeve

bashkëkohore, i cili mundëson gjenerimin e të gjitha raporteve të kërkuara. Përmbyshja e standardeve u finalizua me përfshirjen e Institucionit në skemën e ASD-së.

Gjatë vitit 2018 **FED invest** synon implementimin e një **Sistemi Operativ TIK** për të mbështetur platformën e ofrimit të një game më të gjerë shërbimesh si: shërbimet utilitare të ndryshme (remitancat, pagesa e ujit, dritave, gjobat, të tjera administrative), llogari online, transaksione apo edhe transfertat ndërmjet anëtarëve, etj. Gjithashtu, në kuadër të projektit me **JICA**, është dakordësuar marrëveshja për përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme informatike të Institucionit, si në *software* dhe në *hardware*.

1. INFORMACION



INFO ME SMS

- Shërbime me SMS
Financiare dhe Bujqësore

2. BRANCHLESS BANKING



FAZA PILOT E MBËSHTETUR NGA JICA

- Të shkojmë drejt fermerit
- Teknologji mobile
- Përputhshmëria biometrike

3. MIS I RI



Sistemi i Ri MIS i përshtatur me strukturat e reja

- Rritja e sigurisë dhe transfertave
- Bankingu në distancë



Në foto: Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Kursim Kreditit FED invest, 29 Prill 2017

KOOPERATIVA FINANCIARE MË E MADHE NË SHQIPËRI

FED invest është zhvilluar mbi eksperiencën dhe ekspertizën 25 vjeçare të Shoqërive të Kursim Kreditit në Shqipëri, si një model i bazuar në bashkëqeverisje, ku në themel është anëtari.



Më 31 Dhjetor 2017

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Aktivet	31 Dhjetor 2017
Mjete monetare	179,656
Depozita në Banka	841,511
Letra me vlerë (Eurobond)	120,567
Interesa Pjesëmarrës	718
Kredi neto	3,317,652
Aktivet afatgjata materiale	125,310
Aktivet afatgjata jomateriale	8,107
Aktive të tjera	17,217
Totali i aktiveve	4,610,738
Detyrimet	
Hua afatshkurtër	601,335
Hua nga Unioni SHKK	-
Fonde për rezervë statistikore	70,137
Depozita të anëtarëve	3,492,957
Detyrime të tjera	75,442
Grante të amortizueshme	3,370
Totali i detyrimeve	4,243,241
Kapitali	
Kapitali i paguar	137,990
Rezervat	214,163
Rezultati i periudhes	15,344
Teprica (deficit) i mbartur	-
Total i kapitalit	367,497
Total i detyrimeve & kapitalit	4,610,738

Më 31 Dhjetor 2017

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

FED invest	31 Dhjetor 2017
Të ardhurat nga interesat e kredisë	469,463
Shpenzime për interesat	(91,224)
Të ardhura neto nga interesi	378,239
Rimarrje / Shpenzime nga zhvlerësimi i huave	(27,969)
Të ardhura neto pas zhvlerësimit	(27,969)
Të ardhura nga komisionet	48,360
Totali i të ardhurave nga komisionet	48,360
Të ardhura nga investimet	27,378
Shpenzime interesi për huatë	(26,040)
Të ardhura jo operative neto	1,424
Të ardhura të tjera neto	2,762
Shpenzime për personelin	(225,163)
Shpenzime administrative	(151,974)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(8,911)
Totali i shpenzimeve	(386,048)
Teprica/ (deficiti)	15,344



Grant Thornton

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.granthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Drejtues të FED invest

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kursim Kreditit FED invest (“Organizata”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi mbikëqyrjen e shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre”.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi mbikëqyrjen e shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre”, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabel të vijmësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
28 mars 2018

Kledian Kodra, FCA
Kodra



Objektivat e vitit 2018 të FED invest:

- Rritja e gamës së produkteve dhe një shërbim sa më cilësor.
- Rritja e volumit të portofolit të kredisë dhe mbajtja e tij në parametra cilësorë.
- Zhvillimin e Njesisë Agro dhe SME sipas strategjive të Agrofinancës.
- Rritjen e kapaciteve përmes trajnimeve dhe zgjerimit të stafit.

Objektivat e FED invest përfshijnë programe për manaxhimin e likuiditetit, qasjen e integruar për manaxhimin e risqeve, sigurimin e një kapitalizimi të qëndrueshëm, përmirësimin e cilësisë së aseteve, të udhëhequr nga filozofia e vendosjes së anëtarit në qendër.

Rritjen e kapaciteve të IT dhe futja e teknologjive të reja





TIRANË

Rr. Qemal Stafa, pll.9 Katësh,
nr.70, Pazari i Ri



TIRANË Rurale

Rr. Derhemi, Pallati Son



TIRANË Urbane

Rr. Muhamet Gjollësja, Pallati nr.15



ELBASAN

Rr. Qemal Stafa,
Përballë Muzeut Etnografik



KORCË

Lagjja 9, Rruga Midhi Kostani



POGRADEC

Lagjja 3, Rr.Fan Noli,
Pallati Xhemollari



LIBRAZH

Lagjja nr. 2, Rr. Adrian Edgar



PEQIN

Blvd. Mustafa Gjinishi,
Lagjja Teqe.



GRAMSH

Lagjja Sporti, Pallati Osmani



LUSHNJE

Rr. Kongresi i Lushnjes



BERAT

Lagjja 22 Tetori, Sheshi Agjensia, Vila e Zeres



DURRËS

Lagjja nr. 3 Rruga Tregtare, Godina nr.97



KAVAJË

Blvd "Indrit Cara", Lagjja nr. 4



SHKODËR

Rr. "Gjylbegaj",
Lagjja "Kongresi i Permetit"



VLORË

Lagjja "Skelë", Rruga "Ismail Qemali", Pallati Xhaxho



SARANDË

Lagjja nr.1, Rruga Skënderbeu,
Godina nr.11



GJIROKASTËR

Rr. 18 Shtatori



FIER

Lagjja Kastrioti, Rruga Brigada XI Sulmuese,
përballë DPTT



LEZHË

Lagjja Besëlidhja, Rr. Kosova, pll. 181



PËRMET

Lagjja Varosh, Rr. Meleq Gosnishti,
përballë Gjykatës së Rrethit



Dega Tregan



Dega Mollas



Dega Vlorë



Dega Seman



Dega Korçë



Dega Pogradec



Dega Berat



Dega Kuçan



Dega Fier



Rr. Qemal Stafa, nr.70
Tiranë, Shqipëri
Tel/Fax: + 355 4226190/1
www.fedinvest.al
info@fedinvest.al